

VENDIM
Nr.200, datë 2.5.1997

PËR DISA MASA PËR FORCIMIN E RUAJTJES SË MALLRAVE, PAJISJEVE E
OBJEKTEVE USHTARAKE DHE SHTETËRORE

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ndalohet grumbullimi, transporti i artikujve të përcaktuar në kreun 72 deri 81; 84.25 deri në 84.33; 85.01 deri 85.14 dhe kreun 93, sipas emërtesës së mallrave në fuqi, pa pasur autorizimin përkatës nga organi kompetent. Lista e mallrave të mësipërme përcaktohet në aneksin nr.1.

2. Ndalohet grumbullimi, transportimi dhe përpunimi i të gjitha llojeve të mbeturinave, skrapeve, pjesëve të makinerive, radiatorëve, tornove, frezave, pjesëve të armëve, municioneve dhe llojeve të tjera, si dhe prodhimi i lingotave dhe kallëpeve të derdhura nga këto materiale.

3. Të sekuestrohen të gjitha linjat dhe fonderitë e ngritura pa lejen e organeve kompetente, të cilat merren me grumbullimin dhe përpunimin e skrapeve të të gjitha llojeve.

4. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.360, datë 10.7.1995, pas paragrafit të fundit të pikës 2 shtohen paragrafët e mëposhtëm:

- Çeliquet të pandryshkëm (7218).
- Materiale për ndërtimin e hekurudhës, si shina, pllaka mbështetëse e pjesë të tjera të kësaj natyre (7302).

- Konstruksiione e pjesë konstruktive të urave (7308).

- Rezervuarë dhe depozita (7309).

- Tela të të gjitha llojeve (7312-13).

- Zinxhirë dhe pjesët e tyre (7315).

- Makineri të të gjitha llojeve dhe pjesët e tyre, si torno, freza etj.

5. Me forcat e policisë së Ministrisë së Brendshme, policisë ushtarake dhe të policisë tatimore doganore të krijohen postbloqe (trupojë), në vendkalimet e mundshme të kufirit shtetëror dhe në rrugët që të çojnë në to. Këto postbloqe shpallen objekte të rëndësisë së veçantë.

6. Organet e policisë së strukturave, të përmendura në pikën 5, të forcojnë masat e kontrollit për ndalimin e eksportimit të mallrave, armatimit, municionit, teknikës luftarake, pjesëve të tyre, si dhe të çdo pajisjeje tjetër ushtarake.

7. Ministria e Mbrojtjes të marrë masa për bllokimin e rrugëve që të çojnë drejtpërdrejt në territorin e depove ushtarake. Hyrjet e depove , tuneleve dhe territori rreth tyre të minohen.

8. Ruajtja e objekteve ushtarake të kryhet me oficerë, nënoficerë, ushtarë aktivë dhe roja rezerviste.

9. Ministria e Brendshme të dorëzojë në garnizonet ushtarake të përcaktuara nga Ministria e Mbrojtjes, armatimin, municionin dhe pajisjet ushtarake që kapen, sipas ligjit të gjendjes së jashtëzakonshme.

10. Ministria e Mbrojtjes të marrë masa për reduktimin dhe përqendrimin e depove të armatimit e municionit, duke parë edhe mundësinë e sigurimit të ndihmës nga forcat shumëkombëshe që veprojnë në Shqipëri.

11. Në rast shkeljeje të pikave 1, 2, 4 të këtij vendimi ndaj personave fajtorë, përveç rasteve të parashikuara në ligj, të sekuestrohen mallrat e kapura dhe mjetet e transportit.

12. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino

ANEKSI NR.1

Lista e mallrave kryesore që ndalohen të grumbullohen dhe të transportohen pa autorizimin e organit kompetent

1. Hekur dhe çelik i palidhur me lingota ose forma të tjera (7226)
 - 1/1 Çeliqe të pandryshkshëm (7218)
2. Bakër dhe çdo artikull prej tij (74)
3. Nikel dhe artikuj prej tij (75)
4. Alumin dhe artikuj prej tij (76)
5. Plumbi (78)
6. Zinku (79)
7. Kallaj (80)
8. Materiale të tjera si tungsten, molibden, kobalt, titanium (81)
9. Makara, vinça, kriket ngritës dhe pjesët e tyre (8425)
10. Vinça, vagonë etj. dhe pjesët e tyre (8426)
11. Vagonë ngritës me pirun, vagonë të tjerë dhe pjesët e tyre (8427)
12. Makineri të tjera ngritëse, ngarkim-shkarkimi, teleferikë, ekskavatorë dhe pjesët etj (8430)
13. Buldozerë dhe pjesët e tyre (8429)
14. Armë, municion dhe pjesët e tyre (93)
15. Materiale të ndërtimit hekurudhor, si shina, pllaka mbështetëse e pjesët e kësaj natyre (7302)
16. Konstruksiione e pjesë konstruktive të urave (7308)
17. Rezervuarë dhe depozita (7309)
18. Tela të të gjitha llojeve
19. Zixhirë dhe pjesë të tyre
20. Motorë të të gjitha llojeve
21. Makineri të të gjitha llojev e dhe pjesët e tyre,